



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 11

Datë: 02. 02. 2021. Ora: 17:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Shqyrtimi dhe miratimi procesverbalit të mbledhjes Nr.06 dhe 07/2021
3. Aktivitetet e ZRPPC-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve në vendvotim nga 750 në 950

5. Rekomandim nga DOZ: Për përfshirjen e votuesve të aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit
 6. Certifikimi i Listës Përfundimtare të votuesve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021
 7. Shqyrtimi dhe miratimi i fletëvotimit dhe broshurës për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021
 8. Të ndryshme.
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përsëndetje të gjithëve. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 11 të KQZ-s. A ka dikush ndonjë pikë të rendit të ditës, apo ndonjë çështje me rendin e ditës. Kush është për rendin e ditës? Fillojmë me pikën e parë, procedimi i procesverbalit të mbledhjes 6 dhe 7. A ka dikush vërejtje? Urdhëro Qemajl.

2. Shqyrtimi dhe miratimi procesverbalit të mbledhjes Nr.06 dhe 07/2021

Lidhur me procesverbalin e kaluar, bëri vërejtje z. Qemajl Kurteshi i cili, kërkoi që diskutimet e tij të përfshihen më gjerësisht, në procesverbale...

Sami Kurteshi: Unë i kam parë, i kam hapur, nuk kam mundur ti lexoj me kujdes dhe nuk mund të marr vendim në lidhje me këto.

Valdete Daka: Përveç vërejtjeve të Qemajlit, a ka dikush vërejtje tjetër. Kush është për aprovimin me vërejtje e Qemajlit dhe me sugjerim që të përmirësohet? Kush është kundër? Abstenim? Vazhdojmë me pikën tjetër aktivitetet e ZRPP-s.

1. Aktivitetet e ZRPPC-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

Ylli Buleshkaj: Ashtu sic jeni të njoftuar tash, është koha e aplikimit dhe akreditimit të vëzhguesve e kemi grupin e tret të akreditimit të vëzhguesve siç e keni para jush. Pasi që kemi vëzhguar i keni para jush ata që ju është verifikuar aplikacioni i tyre. Jemi në shqyrtim të një grupi shumë të madh, diku 10.000 vëzhgues. Pra para jush presim ti akreditoni 211 vëzhgues nga Instituti Demokratik i Kosovës, 656 vëzhgues nga PDK-ja, 5 vëzhgues nga OJQ-ja vendore ERMI-n, 180 vëzhgues nga Syri i Vizionit OJQ vendore po ashtu, 31 vëzhgues nga Cente Za Miri Toleranciu, 20 vëzhgues nga OJQ-ja vendore Demokraci Plus, 14 nga Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut, 21 vëzhgues nga Inter New`s Kosova, 49 vëzhgues nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese BIRN, 25 vëzhgues nga subjekti LVV-je, 3 vëzhgues nga media ndërkombëtare Vizion Plus, 29 vëzhgues nga Center Infusion Graçanica, 2 vëzhgues nga ARD-ja, 70 vëzhgues nga OJQ-ja vendore Qendra për Edukim Inovacion dhe Zhvillim Profesional Akademia si dhe 3 vëzhgues nga media ndërkombëtare Anadolu. Të gjithë këto subjekte i kanë sjellë dokumentacionin e duhur dhe i plotësojnë kushtet për tu akredituar vëzhguesit e tyre.

Valdete Daka: Faleminderit. A ka dikush vërejtje?

Kush është që të akreditohen 211 vëzhgues nga KDI? Kush është që të akreditohen 656 vëzhgues nga PDK-ja? Kush është që të akreditohen 5 vëzhgues nga OJQ-ja ERMIN? Kush është që të akreditohen 180 vëzhgues nga OJQ-ja Syri i Vizionit? Kush është që të akreditohen 31 vëzhgues nga Center Za Miri Toleranciu? Kush është që të akreditohen 20 vëzhgues nga OJQ-ja Demokraci Plus? Kush është që të akreditohen 14 vëzhgues nga Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut të Kosovës? Kush është për akreditimin e 21 vëzhguesve nga OJQ-ja vendore Inter New`s Kosova? Kush është për akreditimin e 49 vëzhguesve të Rrjetit Ballkanik të Gazetaris Hulumtuese BIRN? Kush është për akreditimin e 25 vëzhguesve të subjektit politik LVV? Media ndërkombëtare Vizion Plus me 3 vëzhgues? 29 vëzhgues nga OJQ-ja vendore Center për Social Pink Graçanica? Media ndërkombëtare ARD me 2 vëzhgues? 70 vëzhgues nga OJQ-ja vendore Qendra për Edukim Inovacion dhe Zhvillim Profesional Akademia? Dhe 3 vëzhgues nga media ndërkombëtare Anadolu Agency AA? Faleminderit.

(Ps. Akreditimi i të gjithë këtyre vëzhguesve, u bë vec e vec)

Ylli Buleshkaj: Nga nesër fillon fushata zgjedhore e cila zgjat deri me 12 shkurt të këtij viti. Të gjitha instucionet relevante duke përfshirë edhe KKV-t janë të informuara për këto afate. Ajo që është shumë e rëndësishme është që të gjitha subjektet politike që janë certifikuar që ti përmbahen jo vetëm rregullave të KQZ-s por edhe rregullat të cilat i ka specifikuar Ministria e Shëndetësisë dhe ISHP-ja, sepse përgjegjës për zbatimin e këtyre masave nuk është KQZ-ja apo PZAP-i por është inspektoratet përgjegjëse shtetërore.

Pra të gjithëve ju kërkohet që përveç rregullave e kodit të mirësjelljes duhet ta respektojnë edhe këtë kornizë shtesë ligjore. Vetëm si rikujtim...

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të numrit të vendvotimit të votuesve nga: 750, në 950.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve në vendvotim nga 750 në 950

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtar të KQZ-s kjo pikë ka ardhur si nevojë emergjence për tu trajtuar në KQZ e cila nuk është trajtuar në KOZ për çështje të cilat dihet dhe si rrjedhojë kemi ardhur direkt në KQZ për të cilën na nevojitet vendimmarrje. Sipas ligjit për zgjedhjet e përgjithshme asnjë vendvotim brenda qendrës së votimit nuk e tejkalon numrin 750 votuesve. Mirëpo nga praktikat e mëhershme në të gjitha proceset zgjedhore KQZ-ja e ka rritur në 950 dhe në bazë të saj është krijuar edhe lista përfundimtare e votuesve, pra bazën ligjore e ka, praktikën e ka dhe rekomandimi është që numri maksimal i votuesve për vendvotim të jetë 950.

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim? Miratohet. Vazhdojmë me rekomandimin nga KOZ-i, për përfshirjen e votuesve të aprovuar në listën përfundimtare të votuesve jashtë vendit.

4.Rekomandim nga DOZ: Për përfshirjen e votuesve të aprovuar në Listën Përfundimtare te Votuesve Jashtë Vendit

Burim Ahmeta: Po ashtu edhe kjo pikë ka ardhur si nevojë emergjente për shkak se lidhet me listën përfundimtare të votuesve e cila po ashtu nuk ka mundur të trajtohet në KOZ. Dhe është fjala për 37,896 aplikues të cilët janë aplikues të suksesshëm dhe e kanë të konfirmuar zotësinë juridike dhe për të cilët nuk është arritur akoma të konfirmohen përmes telefonit dhe rekomandimi është që të gjithë të pranohen si votues jashtë vendit. Rekomandimi është që të përfshihen dhe të marrin statusin e votuesit me zotësi juridike të regjistruar për të votuar si votues jashtë vendit. Ky është rekomandimi nga sekretariatit...

Valdete Daka: Ashtu siç u cek sot sipas planit operacional ka qenë e planifikuar që të certifikohet lista e votuesve me datën 2 shkurt 2021. Po ashtu edhe sot fillon periudha e votimit për aplikuesit që janë regjistruar suksesshëm për të votuar përmes postës. Pra rekomandimi është që të gjithë ata që kanë aplikuar suksesshëm dhe janë vlerësuar nga KQZ-ja të hyjnë në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe ky

numër në total është 103,582 votues. Kur të vije në radhë edhe certifikimi i listës së votuesve të Kosovës dhe atyre jashtë Kosovës do ti kemi edhe shënimet e sakta kush është refuzuar dhe pse janë refuzuar, po ashtu edhe listën përfundimtare të votuesve. Pra kush është që të aprovohet rekomandimi i DOZ-it e ajo është që në këtë listë të përfshihet një numër i suksesshëm jashtë Kosovës e që është në total 103,582, pra të gjithë ata që kanë plotësuar kushtet ligjore të parapara me ligj ?

Arianit Elshani: E para dua të falënderoj stafin e SKQZ-s, e cila ka bërë një punë të jashtëzakonshme lidhur me procesion e aplikimit dhe regjistrimit të personave nga jashtë të diasporës. Të cilët kanë aplikuar në një numër jashtë zakonisht të madh në këto zgjedhje ndryshe nga zgjedhjet e kaluara të vitit 2019 dhe vitit 2017. Është një numër që ka arritur realisht deri 103,000, kanë qenë aplikime që kanë qenë nga jashtë ku 30,000 nuk e kanë vërtetuar zotësinë e tyre juridike, 103,000 kanë dorëzuar aplikacionin e tyre dhe kanë dërguar kopjen e identitetit këtë rast letërnjoftimin apo ndonjë dokumenti tjetër nga jashtë. Dua ta falënderoj posaçërisht edhe si përfaqësues i PDK-s por dhe anëtar i KQZ-s për një pjesëmarrje jashtëzakonisht të madhe të diasporës në këto zgjedhje. Tjetra që ta sqarojmë edhe për opinionin publik me qenë se kanë pasur thirrje të një numri jashtë zakonisht të madh, qindra persona më kanë kontaktuar edhe nga jashtë që kanë qenë të interesuar që fortë se pse nuk po realizohen thirrjet apo pse nuk janë kontaktuar, për mënyrën si janë kontaktuar apo edhe oraret se kur janë kontaktuar. Pra të sqarohemi për opinionin publik se po përfshihen edhe ata persona që nuk kanë arritur të thirren brenda kësaj periudhe kohore, pra po përfshihen në listën përfundimtare të votuesve.

Pra, është rekomandim edhe nga SKQZ-ja që po përfshihen të gjithë personat brenda kësaj liste dhe kanë të drejtën e votës deri në verifikimin e tyre, pavarësisht se nuk është arritur brenda kësaj periudhe kohore ata do të kontaktohen mirëpo të dërgojnë votën e tyre me post e kanë. Dhe ta sqarojmë për të gjithë ne realisht edhe si KOZ është dashur që dje të përfundoj ky proces mirëpo dje një mbledhje ka dështuar brenda KQZ-s nuk ka arritur të përmbillet që të publikohet edhe fletëvotimi për arsye të ndryshme e që ndoshta kishin pasur mundësinë të aplikojnë që nga orët e para të mëngjesit. Mirëpo është një e arritur e mirë që së paku të arrijmë sot ta finalizojmë këtë çështje ta publikojmë edhe fletëvotimin, ta publikojmë edhe listën përfundimtare të 103,000 votuesve nga jashtë dhe të votojnë për preferencat e tyre politike. Faleminderit edhe njëherë kryetare.

Valdete Daka: Faleminderit Arianit. Pra edhe njëherë ta saktësojmë se të gjithë ata të cilët kanë dokumentuar zotësinë juridike të tyre kanë bashkangjitur dokumentacionet që janë verifikuar nga shërbimi i listës votuese, janë përfshirë në listën përfundimtare të votuesve dhe do ta kenë të drejtën të votojnë që nga momenti kur pak pas çastesh e aprovojmë edhe fletëvotimin dhe e shpallim në ueb-faqen

ton. Pra askujt nuk do ti mohohet e drejta të votoj dhe të gjithë do ta kenë këtë të drejt. E falënderoj edhe unë mërgatën për një përgjigje në thirrje kaq të madhe të aplikojnë dhe të regjistrohen si votues jashtë Kosovës. Si dhe të ndjejnë mirëkuptimin e afateve jashtë zakonisht të shkurtra të cilat edhe ndoshta na kanë sfiduar por edhe kemi arritur megjithatë të kontrollohen të gjitha e-mailet të cilat kanë ardhur në adresën e KQZ-s dhe të gjithë të kontrollohen, pra nuk ka mbetur asnjë e-mail pa kontrolluar dhe asnjë e-mail nuk ka mbetur pa u verifikuar dhe asnjë qytetar nuk ka mbetur pa u verifikuar sa i përket zotësisë juridike. Ne po ashtu kemi arritur që nëpërmjet telefonatave të verifikojmë një numër jashtë zakonisht të madh mbi 80,000 qytetar janë thirrur që është një operacion i jashtë zakonshëm, edhe pse nuk kemi arritur ti përfundojmë telefonatat për të gjithë. Ne megjithatë nuk do t`ju pamundësojmë askujt që të mos votoj, pra të gjithë ata që nuk janë thirrur, apo përgjigjur në telefonata do të kenë mundësinë të votojnë. Ta kemi të qartë, askujt nuk ju është mohuar e drejta që të votoj për shkak të telefonatave. Dhe megjithatë ky verifikim ka arritur qëllimin e vet e ajo është që ne mesin e atyre të cilët janë kontaktuar ka pasur qytetar që kanë deklaruar se nuk janë ata persona të cilët kanë dërguar aplikacione. Pra nuk është lejuar që asnjë që nuk është votues i vërtetë të mos votoj. Sepse mos harroni edhe një votë e cila është e manipuluar mund të përfundoj. Qëllimi është arritur. Megjithatë të gjithë qytetaret nga diaspora do ta kenë të drejtën që nga sot, pas disa çasteve kur të aprovohet fletëvotimi të fillojnë të votojnë.

Sami Kurteshi: Kërkesa e drejt për drejt është për shkak se KQZ nuk ka mundur ti respektoj afatet e veta për sfidim, konfirmim, certifikimin e listës dhe nuk ka mundur që t`ju lejoj në afatin kur e ka paraparë. Pajtohem se është numër shumë i madh, kërkoj që KQZ-ja të merr një vendim që ta shtyjë datën e pranimit për dërgesat me postë jashtë vendit për 10 dit dhe t`ju lejoj të gjithë atyre personave që kanë aplikuar dhe për çfarë do arsye janë refuzuar ta shohin listën të kenë mundësin e shfrytëzimit të mjeteve juridike dhe të sfidojnë vendimin qoftë të KQZ-s apo qoftë edhe vendime të tjera. Nëse ne nuk i lejojmë që ta shfrytëzojnë të drejtën për shfrytëzimin e mjeteve juridike ne bëjmë një vepër penale. E dyta, ne e kemi kaluar afatin kur është dashur të fillohet votimi për arsyet që qytetarët nuk mund ti dinë, nuk mund ti marrin me mend por edhe nuk mund të vendosin. Ky është vendim i KQZ-s edhe çfarëdo cenimi i të drejtës sipas ligjit që do të thotë konsumin i veprës penale do të duhej të shihet parasysht. Unë mendoj se KQZ si instucion e ka një obligim edhe moral edhe ligjor për shkak të tejkalimeve të afateve t`ju kërkoj falje publike të gjithë qytetarëve që janë shqetësuar për arsye të ndryshme qytetarëve jashtë Kosovës. Ky është krejt moral dhe krejt ligjor, krahas kësaj është e domosdoshme që tu lihet të gjithë atyre që janë refuzuar 29,000-30,000 t`ju lihet mundësia e sfidimit qoftë edhe e listës prej 103,000 sepse ka mundësi që në atë listë është mundësia që ndokush nuk e ka të drejtën e votimit po edhe të listës së atyre që janë refuzuar dhe ka mundësi që për çështje krejt të thjeshta teknike ku ka pasur që kanë harrur nënshkrimin ta qesin,

kanë harruar të shkruajnë numrin e telefonit por mund të ketë edhe gabime teknike ashtu siç i bëjmë ne për çdo dit edhe në dokumente zyrtare tonat. Dhe gabimet teknike nuk janë arsye qoftë edhe ndonjë gabim pak më i madh nuk janë arsye që të mohohet një e drejt kushtetuese. Kjo është e domosdoshme kërkesa për shtyrjen e afatit të pranimit të dërgesave me post nga bota e jashtme.

Ne, e dimë se kemi një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese që nuk ka marr parasysh asnjë rrethanë objektive dhe në rastin konkret ky aktgjykim tregohet si absurd dhe i pa vlerë sepse instucionet shtetërore nuk ka mundur t`ju rrinë apo shpalljen e detyrave që ju është caktuar vetës që ju është caktuar qytetarëve afatet që ju janë dhënë. Kjo është kërkesa e par, kërkesa e dytë që po e bëjë publike është që PZAP-i ta mundësoj ushtrimin e të drejtës për shterjen e mjeteve juridike në mënyrë elektronike për të gjithë ata persona që janë jashtë vendit. Është absurde të mbyllet e të bunkerizohet një instucion dhe mos të lejoj shfrytëzimin e mjeteve juridike duke e ditur saktësisht se një komunikim me post fizik është i pa mundur dhe i tejkalon të gjitha afatet dhe nuk e ka asnjë kuptim. Këto janë kërkesat e mia të drejt për drejta, numri i aplikuesve është rritur. Është rritur jashtë pritjeve që ka pasur KQZ-ja, qytetarët kanë arsyet e veta për këtë rritje por unë mendoj se KQZ-ja duhet të dal përball me vendimet e veta edhe me qëndrimet e veta duke ua mundësuar shfrytëzimin e të gjitha të drejtave që ata i kanë të garantuara me kushtetutë por edhe me ligj. Kjo do të thotë sfidimin e vendimeve të KQZ-s, së pari në KQZ e pastaj edhe në PZAP. Faleminderit.

Valdete Daka: Vetëm sa për sqarim për opinionin. Periudha e votimit përmes postës nëpërmjet planit operacional është përcaktuar që të filloj sot. Edhe po ashtu dizajnimi i fletëvotimit dhe broshurës është dashur që të miratohet, por sot do miratohet, është data 2 shkurt. Pra ne jemi në kuadër të afateve dhe aq më tepër duke marr parasysh që ka qenë një numër i jashtëzakonshëm të cilin nuk e ka paraparë askush e aq më tepër duke marr parasysh se kemi afate që janë jashtëzakonisht të shkurta. Sa i përket PZAP-it, unë nuk mundem të jap informacione për instucione që nuk janë ajo është çështje e PZAP-it. Ndërkaq sa i përket votimit, fillon sot momentin që ne e aprovojmë fletëvotimin. Pra në momentin që ne e aprovojmë fletëvotimin fillon votimi.

Alim Rama: Gjithsesi e mbështesim aprovimin e 103,000 sa kanë qenë. Por sa i përket afateve ju referuat afatit të certifikimit të listës. Këtu shkelja u bë me publikimin e listës preliminare, t`ju mundësohet e drejta e atyre 30,000 sa kanë qenë që të sfidojnë KQZ-n ose PZAP-in. Asnjë qytetar që nuk ndodhet në këtë listë që publikohet sonte nuk e di pse nuk është në listë. Edhe e drejt e atyre qytetarëve potencialisht edhe në qoftë ka pasur lëshime teknike në sekretariat, në shtypje nuk janë në gjendje të dinë pse nuk janë në listë kërkesa për shtesën e kësaj kohës është dhe vetëm jepet e drejta e ankimit të atyre qytetarëve dhe në

çoftë se shtyhet për 10 ditë i bie se gjithësi qytetari e dërgon votën para zgjedhjeve nuk ndikon në rezultat, por edhe ata kanë për të pasur mundësinë në çoftë se aprovohet kërkesa e tyre me votuar. Faleminderit.

Valdete Data: Vetëm sa për informatë, për dijeninë time a janë njoftuar ata qytetar pse janë refuzuar.

Burim Ahmetaj: Pas miratimit të listës votueseve jashtë vendit lista do të publikohet për të gjithë votuesit e suksesshëm dhe si rrjedhojë ata që nuk mund ta shohin vetën në listë i bie që janë të refuzuar. Kjo është praktika që ka ndodhur edhe vitet e kaluara po ashtu edhe në vitin 2019 nuk kemi pasur periudhë të sfidimit për shkak të afatit shumë të ngjeshur si rrjedhojë edhe vitet paraprake thajse asnjërin nuk e kemi pasur dhe nuk kemi mundur ta japim mundësinë e sfidimit të listës përfundimtare të votuesve. Mirëpo momentin që publikohet lista e votuesve jashtë vendit dhe të gjitha aplikuesit që nuk mund ta gjejnë emrin në listën e votuesve jashtë vendit mund ti shfrytëzojnë mjetet juridike duke ju adresuar PZAP-it në këtë rast.

Sami Kurteshi: Pikërisht ky është ai momenti në të cilin e përmendëm edhe të cilin KQZ-ja nuk ka drejt ta tejkaloj ajo është obligim ligjor dhe kushtetues ajo nuk varet nga afatet që i kemi ne. Unë e marr me mend se sekretariati dhe krejt ata njerëz që kanë punuar në trajtimin e aplikacioneve kanë pasur një punë të jashtëzakonshme. Pse ka ardhur deri tek kjo punë e jashtë zakonshme unë nuk dua ta diskutoj tani sepse ka pasur kërkesa të tjera për tu lehtësuar kjo punë, nuk është bërë dhe ka ardhur deri tek kjo punë. Këto afate mundet ti shkurtoj KQZ-ja por këto afate nuk mundet ti mohoj KQZ-ja dhe nuk ka të drejt asnjë instucion tjetër ta mohoj të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike. Cila ka qenë praktika, ndoshta ka qenë në 2019 ndoshta ka qenë edhe më përpara po ata e kanë një të drejtë ligjore që duhet ta shfrytëzojnë edhe unë nuk po them se të gjithë ata kanë të drejtë mirëpo unë po them gjithë ata kanë të drejtë shfrytëzimin e mjeteve juridike jo se i plotësojnë kushtet. Edhe ne nuk mund tua mohojmë në asnjë mënyrë as si KQZ, as si PZAP, as si Gjykatë Supreme dhe as si Gjykatë Kushtetuese, sepse ajo është një e drejtë kushtetuese dhe nuk varet nga vendimet apo nga afatet e ngjeshura të instucioneve të ndryshme në të gjithë e dimë se janë zgjedhje të jashtë zakonshme me afate të shkurtuara. Mirëpo në afate të shkurtuara ata kanë pasur, një, dy apo tri ditë por edhe ato ua kemi mohuar. Prandaj kërkesa që ata ta kenë këtë mundësi sepse ankesa në PZAP tani e tutje dhe eventualisht dhënjë e të drejtës vetëm një njeriu nuk ka asnjë kuptim sepse vota e tij më nuk mund të numërohet, kjo është çështja. Prandaj kërkesa është legjitime, e drejtë që njerëzve t'ju mundësohet që ti shtjerrin gjitha mjetet juridike për të realizuar një të drejtë që ua garanton kushtetuta dhe ligji për zgjedhje. Kjo është kërkesa nuk ka diçka tjetër, prandaj unë po kërkoj nga KQZ-ja përveç miratimit të kësaj liste prej 103,000 aplikuesve të suksesshëm edhe ndërprerjes së telefonatave të zgjatet afati i pranimit të postimit të votave nga jashtë për shkak se KQZ-ja

nuk i ka respektuar afatet ligjore të parapara me vendimet e veta, dokumentet e veta, jo dikush tjetër por ne këtu. Për ndryshe asnjë ankesë e tyre nuk ka kuptim sepse ajo zgjat me disa dit, në rastin më të mirë katër dit, në rastin më të keq tetë dit dhe përfundon afati i dërgimit të postës.

Valdete Daka: Askush nuk ua mohon të drejtën që ata të ankohen por po ashtu çoftë se ata pranohen si votues jashtë Kosovës me siguri se PZAP-i duhet të na aplikoj pranimin e votës së tyre. Kështu që aty jemi në rregull sepse nuk kishte me pas kurrfarë kuptimi nëse i aprovohet votuesit mos ti aprovohet vota, kështu që atë e rregullon PZAP-i.

Arianit Elshani: Në çoftë se vendoset që të zgjatet duhet ta respektojmë sepse është edhe ajo e kundërshtimit dhe sfidimit të listës aty i bie që të shkurtohet edhe koha për votim dhe kështu që duhet të kemi parasysh këtë aspekt. Nëse ne sot marrim vendim që ti lejohet ajo mundësi edhe pse ata e kanë në PZAP dhe PZAP-i e ka të detyrueshëm që brenda 24 orëve të kthej përgjigje dhe ti mundësoj votimin në çoftë se vërtetohet ajo. Ta kemi parasysh që çoftë se vendosim sot të publikojmë listën e atyre për sfidim dhe kundërshtim i bie që të shkurtohet afati për diasporën sepse pastaj tek pas tri dite dikush e sfidon, dikush largohet nga lista. Ta kemi parasysh këtë aspekt teknik, procedural, por parimisht pajtohem me Z. Kurteshi që t'ju mundësohet një çështje e tillë nga PZAP-i që e drejta e ankesës dhe votës elektronike.

Sami Kurteshi: Unë nuk po shoh ndonjë mospajtim parimor. Unë mendoj se lista prej 103,000 aplikuesve të suksesshëm , nuk e di me plane operacionale a është dashur të fillohej sot në mëngjes apo më vonë apo brenda ditës. 24 orë për ta ka rëndësi, sepse 24 orë më vonë edhe posta vjen më vonë dhe nuk pranohet vota. Këtu e kam unë problemin sepse ne po themi 24 orë më vonë ne po e lëshojmë fletëvotimin por nuk jemi në gjendje që të themi 24 orë më vonë prandaj edhe posta që vije e pranojmë dhe ne me veprimet tona se ne jemi vonë nuk po i marrim parasysh vonesat që ja shkaktojmë të tjerëve dhe kjo nuk është në rregull. Unë mendoj se votimi duhet të filloj sa më shpejt kurse ata që kanë të drejtë të sfidojnë dhe eventualisht e fitojnë të drejtën e votës dhe për gjithë këta njerëz të shtyhet afati. Afati është për të gjithë ata njerëz që e dërgojnë një post nga kudo jashtë vendit që është e datuar para ditës së skadimit të afatit të rregullt do të thotë para 13 shkurtit. Nëse ka një vulë ashtu siç e pranon gjykata dërgesën për gjykatat data e dorëzimit në post sepse ne... Gjykata Kushtetuese e ka nxjerr një vendim që në rrethanat objektive dëshmohet si absurd po ne këtë po e themi. Fatkeqësisht që kemi krijuar një sistem të tillë që edhe vendimet absurde duhet të respektohen, por unë po kërkoj që afatet që ne nuk i kemi respektuar tua lëmë në atë kohë njerëzve që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre. Megjithatë unë kisha propozuar KQZ-ja ti bëjë dy gjëra, një me e zgjat afatin dhe dyta ta pranoj këtë vendimin e KOZ-it, të ndërpriten telefonatat dhe të filloj votimi që nga sot.

Valdete Daka: E kemi rekomandimin nga DOZ-i. Kush është për këtë rekomandim? Aprovohet. Pra janë 103,582 votues. E kemi propozimin që të shtyhet afati i pranimit të fletëvotimeve për dhjetë ditë. Kush është për këtë propozim? Faleminderit. Miratohet. Vazhdojmë me pikën tjetër.

Alim Rama: KQZ-ja sot me këtë vendim, ka penguar atyre 30,000 njerëzve me votuar. Ne duhet të kthehemi për çka kemi institucion. Në Kushtetutën e Kosovës, KQZ-ja është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr dhe përgatit të gjitha shërbimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, në të gjitha proceset. Kështu që deri sa ne ua mundësojmë qytetarëve të Kosovës të votojnë në vendvotim po ashtu edhe shtetasve të Kosovës që jetojnë jashtë duhet tua mundësojmë të gjitha. Faleminderit.

Valdete Daka: Para se ta certifikojmë listën përfundimtare kishte me qenë mirë që Premtimi të na jep shpjegime edhe të refuzimeve edhe të gjitha.

5.Certifikimi i Listës Përfundimtare të votuesve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021

Premtimi Rrustemi: Sipas raportit të periudhës së regjistrimit të votuesve jashtë vendit ne kemi pranuar 130,168 fletë aplikacione për regjistrim. Nga 130,168 aplikacione 33 aplikacione janë dorëzuar përmes postës, 195 aplikacione kanë ardhur përmes faksit dhe 129,149 aplikacione janë dorëzuar përmes e-mailit. Prej këtyre 129,149, 102,100 aplikacione janë aprovuar suksesshëm. Këto 102,100 aplikacione të suksesshëm, 88,300 aplikues janë shtetas të Republikës së Kosovës me përqindje i bie 86.55%. Nga ky numër 1,842 aplikues që kanë aplikuar suksesshëm si dëshmi për kriterin e zotësisë juridike e kanë dorëzuar letërnjoftimin, pasaportë ose patentë shoferin janë të UNMIK-ut dhe janë 1.8%. Ndërsa kategoria tjetër prej 11,884 aplikues që kanë aplikuar nuk kanë pasur shtetësi të Republikës së Kosovës të cilët sipas kriterëve juridike përfitimin e votës kanë të drejt për të votuar me përqindje i bie 11.63%. Ndërsa kategoria e dytë që janë refuzuar janë 28,068 aplikacione, janë refuzuar për këto arsye 15,939 aplikues janë refuzuar për shkak se kanë dërguar vetëm formularin e aplikimit për regjistrim ku aplikuesi nuk ka dëshmuar as identitetin as së paku njërin prej kriterëve që shërbejnë si dëshmi për të drejtën e votës. 11,064 aplikues janë refuzuar për shkak se nuk kanë dëshmuar identitetin apo kriterin e zotësisë juridike ose aplikacionet për regjistrim nuk kanë qenë të nënshkruara. 65 aplikues janë refuzuar për shkak se në ditën e zgjedhjeve nuk mbushin kriterin moshën 18 vjeçare. 146 aplikues me qenë se i kanë plotësuar kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesit jashtë Kosovës aplikuesit kanë dërguar aplikacionet për regjistrim edhe për persona me mbiemra të ndryshëm. Me e-mail adresë votuesi mund të aplikoj për

rrethin e ngushtë familjar që ka të njëjtin mbiemër. Ndërsa 470 aplikues megjithëse i kanë plotësuar kriteret juridike për tu përfshirë në listën votuese jashtë Kosovës nuk e kanë lënë numrin në formularin për regjistrim. Ky vendim 42/2021 datës 11 janar 2021 pika dy. Në formularët e aplikimit për regjistrim aplikuesi duhet të shënoj vetëm numrin e tij të telefonit dhe jo të ndonjë familjari. Ndërsa 290 aplikues janë refuzuar për arsye se aplikuesit gjatë verifikimit dhe kontaktimit kanë deklaruar se nuk janë personat konkret ose kanë deklaruar se nuk kanë aplikuar personalisht përmes telefonatave që kemi bërë me këta votues. Bashkangjitur e kemi edhe tabelën e të aprovuarve sipas shteteve. Bazuar në rregullën zgjedhore numër 3/2013 votimi jashtë Kosovës, votuesit që kanë aplikuar suksesshëm dhe janë shtetas të Republikës së Kosovës largohen nga lista votuese që përmes votimit të zgjedhjeve të parakohshme të Kuvendit të Kosovës. Numri i votuesve që janë larguar nga lista përfundimtare e votuesve nëpër komnatat e Republikës së Kosovës është 33,789 votues. Për raportin e votimit jashtë vendit. Lista përfundimtare e kërkuar për regjistrimin e votuesve jashtë vendit, prandaj fillova me atë. Sepse lista përfundimtare e votuesve për zgjedhje të parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës bazohet në ekstraktin e regjistrimit civil. Ky ekstrakt është përpiluar në agjensionin e regjistrimit civil gjegjësisht përpunimit të dokumenteve. Lista përfundimtare për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës përbëhet në 1,794,862 emra të votuesve. Në dallim prej zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 është 143,006 votues më pak. Kjo për arsye se 122,421 votues janë larguar nga lista përfundimtare e votuesve që posedojnë vetëm dokumente të UNMIK-ut. Kategoria tjetër është 11,086 votues janë larguar nga lista përfundimtare e votuesve të cilët janë konfirmuar nga zyrtarët tonë komunal ku të dhënat e tyre janë të marr nga departamenti i pensioneve të Ministrisë dhe Mirëqenies Sociale.

Pas gjithë këtyre, numri i vendvotimit është 883 qendra të votimit ndërsa numri i vendvotimeve është 2,382 vendvotime që i bie 165 vendvotime më pak se në zgjedhjet e vitit 2019. Numri i votuesve që janë regjistruar për herë të parë është 59,631 në këto zgjedhje ku votues të rinj janë 49,198 votues që pas zgjedhjeve të parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë arritur moshën 18 vjeçare dhe do të votojnë për herë të parë në këto zgjedhje. Ndërsa 10,433 votues që nuk kanë qenë në listën përfundimtare të vitit 2019 konsiderohen si votues të rregullt për herë të parë në regjistrin qendror civil. Po ashtu për çdo proces zgjedhor KQZ-ja analizon edhe votat në kusht të zgjedhjeve të fundit, i aplikon ato për zgjedhjet që mbahen. Në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit 2019 numri total i votave me kusht i konfirmuar ka qenë 821 të cilat janë aplikuar në këto zgjedhje. Po ashtu në këto kohë KQZ-ja mundëson shërbimin e ndërrimit të vendvotimit që e kanë më afër nga data 17 janar deri më datën 27 janar, 7,312 votues kanë parashtruar kërkesë për ndërrimin e qendrave të votimit prej tyre janë aprovuar 6,550 kërkesa. Ndërsa bazuar në rregullin zgjedhor numër 02 të vitit 2013 me kërkesë të KQZ-s me datën 15

janar nga KGJK-ja kemi pranuar listën prej 149 personave ku pas verifikimit të dhënave janë larguar gjithsej nga lista votuese 116 persona të cilëve ju është marr zotësia nga KGJK-ja.

Valdete Daka: Për të qenë më të saktë lista përfundimtare e votuesve për këto zgjedhje është 1,794,862 votues. Pra një numër prej 148,006 votues më pak se në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, për arsye të cilat edhe na u prezantuan.

Sami Kurteshi: Faleminderit për ofrimin e të dhënave. Unë kam disa çështje. Çështja e parë është 11,604 aplikues që janë refuzuar për shkak se nuk ju është dëshmuar identiteti ose kriteri i zotësisë juridike dhe ose aplikacionet për regjistrim kanë qenë të pa nënshkruara, kjo është çështja e parë. Njerëzve që nuk kanë nënshkruar një dokument është krejt normale në administratën tonë, një njeri që e mbush një dokument, një formular dhe në fund harron ta nënshkruaj nuk dënohet aq rënd sa ti mohohet e drejta e votës. Kjo është një sanksionim tepër i rënd për një gabim teknik që kanë harruar dhe shumë prej nesh harrojmë, kjo është ajo kërkesa e drejta e sfidimit përveç tjerave nuk e kanë dëshmuar identitetin ose kriterin e zotësisë juridike që i kemi në këtu sepse edhe ata nuk kanë dëshmuar identitetin ose zotësinë juridike 15,993. 65 aplikues në rregull është sepse nuk arrijnë moshën sipas drejtës kushtetuese në zgjedhje për të pasur të drejt vote kjo po më pëlqen jashtë zakonisht shumë që është nxjerr.

Kemi 146 aplikues që janë me mbiemra të ndryshëm ne e kemi diskutuar këtë çështje dhe kemi konstatuar që brenda një familje që kanë adresë të njëjtë munden me qenë një çift që kanë mbiemra të ndryshëm burri dhe gruaja dhe gjithmonë e më shumë kjo dukuri është e shprehur, ata janë një familje të lidhur në kurorë. Kjo është një çështje që duhet të sfidohet. Kemi rastin tjetër 470 aplikues janë refuzuar për shkak se nuk e kanë shkruar numrin e telefonit, nuk i di arsyet pse nuk e kanë shkruar numrin e telefonit. Mirëpo tash po e bëjë krahasimin tjetër tash ndërprehet verifikimi me telefon mirëpo këtyre personave ju jepet e drejta nëse kanë qenë aplikues të suksesshëm i kanë plotësuar të gjitha kriteret e tjera ata nuk verifikohen në telefon, cilin kuptim pastaj e ka telefoni që nuk është shkruar dhe ky që nuk telefonohet thjesht nuk i telefonojnë ose nuk ka mundësi. Këto janë ato elementet që ne duhet ti kemi parasysh që njerëzve tua japim të drejtën e shfrytëzimit të përmirësimit të çfarëdo gabimit apo sfidimit të vendimeve të KQZ-s.

Janë 290 aplikues që shprehimisht kanë deklaruar unë nuk kam aplikuar, shumë e drejt këta duhet të hiqen. Mirëpo i kemi 3 kategori që janë për tu vërtetuar është kategoria e personave me mbiemra të ndryshëm sepse janë shumë 146 por vota e secilit për vetën është sa 1,700,000 të tjerët sepse ai e konsideron votën e vet më të rëndësishme ka bërë përpjekje ta shfrytëzoj të drejtën kushtetuese. 470

aplikues sepse kanë harruar ta shënojnë numrin e tyre të telefonit ose janë lajmëruar në një telefon, çka kishe me qenë shumë e rëndësishme për neve këtu është të dimë sa raste i kemi të njerëzve që mbi dhjetëra që nuk janë të një familje dhe janë lajmëruar nga një numër i telefonit. Cka bëhet me ato raste? E dyta, unë kam n`dëgjuar se ka raste që janë dërguar dhjetëra ose qindra aplikime nga adresa e e-mailit të njëjtë a ka kësi raste ju lutem sepse të tilla dhe cka ka ngjarë me këto raste dhe me telefonin e njëjtë dhe me e-mailin e njëjtë. Unë mendoj se të gjitha rastet, sepse ne jemi instucion që i shërben demokracisë nuk jemi më i rëndësishmi por vendosim jemi tharmi. 290 aplikues kanë deklaruar shprehimisht se ata nuk kanë aplikuar vet dhe nuk duan të marrin pjesë në zgjedhje, çka bëhet në këto raste, çka bëhet me raste që janë disa qindra me të njëjtin numër të telefonit dhe cka bëhet me rastet që janë lajmëruar nga e njëjta adresë e-maili me adresa të ndryshme fizike me mbiemra ta ndryshëm.

Arianit Elshani: Lidhur me numrin e 11,604 aplikues që nuk e kanë treguar identitetin. Personalisht kam qenë dhe e kam vëzhguar procesin dhe në QNR që është bërë verifikimi ku kanë qenë edhe anëtar të tjerë në këtë rast edhe të LVV-s për vëzhgim në QNR, dhe kanë parë se ka shumë aplikacione të cilat nuk janë vërejtur as formulari nuk është vërejtur as të dhënat në kopjen e identitetit që i kanë bërë. I kanë fotografuar me telefon, kualiteti ka dalë shumë dobët nuk janë parë as emrat as mbiemrat. Unë po besoj që janë këto raste që fatkeqësisht janë refuzuar brenda këtyre aplikacioneve. Sa e mbaj mend disa kuti të tilla me formular brenda të cilat nuk janë vërejtur dhe fatkeqësisht është numër i madh i 11,604 nuk kanë arritur ta vërtetojnë zotësinë. Nëse kjo është primare unë besoj që po me atë që kam parë dhe fatkeqësisht nuk kanë arritur ta fotografojnë në një kualitet më të lartë dhe ta dërgojnë përmes e-mailit atë aplikim. Për rastet e 290 personave aplikues pavarësisht numrit të madh të aplikimeve që janë bërë mirëpo edhe këto raste duhet të procedohen në prokurori çoftë se e shohim. Shikoni statistikën nga cili vend janë dhe e shohim që është burimore, ta zëmë e një qyteti e organizuar të inicohen ashtu sic kemi marr edhe vendim.

Sa i përket telefonatave, e mbaj mend që kemi qenë të njëmbëdhjetë anëtarët kur kemi marr vendim edhe ne formën e përfshirjes së formularëve të aplikimit, numrin e telefonit edhe vendimin për verifikim përmes telefonit. Pra janë vendime që i kemi marr bashkërisht njëmbëdhjetë anëtar në KQZ. Për mua ky numër i 290 duhet të procedohet tutje ti rekomandohet edhe KQZ-s, pavarësisht numrit të madh të aplikuesve që kjo del të jetë e vogël çoftë se është e organizuar nga dikush që të manipuloj çdo votë realisht procedohet rasti edhe në Polici në momentin që e kemi në vendvotim e shohim që një fotografi që bëhet brenda një vendvotimi atëherë ajo menjëherë procedohet, hapet rast për shkak të fotografimit. Njëjtë duhet të vepohet edhe në këtë rast nëse mund të jenë të organizuara. Për këtë 11,000 siç e thash

kam parë kualitetet fatkeqësisht kanë qenë të një kualiteti shumë të ulët ato foto sa edhe zyrtarët as Besniku as anëtarët e tjerë të sekretariati nuk kanë mundur ti verifikojnë shkaku i kualitetit të dobët të fotografive që janë bërë në aplikacione dhe mjetet e identitetit.

Alim Rama: Më duket se kemi kuptim të ndryshëm kur vije puna tek verifikimi, numri personal kërkohet që të verifikohet dhe si u shpreh kolegu Kurteshi qëllimi jonë është që t'ju japim mundësi ta ankohen nëse KQZ-ja ka bërë lëshime. Sa i përket numrave një send u dëshmuar në këtë proces që 290 janë refuzuar për arsye se aplikuesit gjatë kohës së verifikimit kanë deklaruar se nuk janë personat e aplikuar ose nuk kanë aplikuar personalisht, ata vetë kanë deklaruar ai ka qenë qëllimi. Qëllimi i thirrjeve telefonike ka qenë që të verifikohet dhe çoftë se ju kujtohet ajo mbledhja, propozimi jonë ka qenë që verifikimi të bëhet në bazë të mostrave. Unë desha ta njoftoj pikë së pari edhe shikuesin se tek rastet e peticioneve mostrat përdoren një ose eventualisht dy, tre%, askush nuk thirret 100%. Ne jemi duke u sill në dy mënyra për qytetarët e Kosovës nuk i verifikojmë gjithsecilin por votuesit atje i thërrasim gjithsecilin në telefon dhe nuk i përmbajmë standardet e njëjta. Me vet faktin që 290 nga 100 e sa mijë i bie që personat që kanë aplikuar janë 99.9%. Është besueshmëria shumë e lart për votuesit jashtë Kosovës, kjo ka qenë një prej arsyeve e cila ka qenë në raportet e BE-s më herët. Kur e lexuat ju vendimin nuk keni përmendur ndërsa tani po thua që numri i mbetur të vazhdohet me verifikim dhe konfirmim 37,000. Por unë mendoj se është shumë me rëndësi ne të respektojmë afatin e ankesave.

Valdete Daka: ne sa i përket qytetarëve në Kosovë sigurisht se i verifikojmë. Ditën e zgjedhjeve kërkojmë të na prezantoni një dokument se askush nuk mundet të votoj pa e pasur një dokument me të cilin identifikohet dhe e ke personin para vetës që e identifikon.

Ibrahim Selmanaj: Unë e kisha falënderuar stafin që ka arritur të na sjell një statistikë. Në të njëjtën kohë ne e kemi para vetës një ofertë por ne duhet të veprojmë shpejt sepse koha nuk pret. Ne jemi duke ecur shumë ngadalë dhe paraprakisht kishim vërejtje se mbrëmë është dashur të veprohet. Jam shumë i sigurt në këto fakte se kur 103,000 aplikues u jepet e drejta nga administrata të votojnë dhe jam i sigurt se nuk ka ndonjë qëllim të caktuar për pjesën tjetër të mbetur. Bëhet fjalë për një proces tepër të ndjeshëm që bëhet nga jashtë Kosovës me kapacitete të cilat i kemi, ne nuk i kemi ato shumë moderne, shumë të sofistikuara. Pra në këtë proces mendoj se kemi bërë më të mirën të mundshme. Në kuadër të kësaj të mirë të mundshme ne duhet të veprojmë tutje dhe duhet ti vërtetojmë njerëzit, duhet ta vërtetojmë votën, duhet ta mbrojmë dhe dëshmojmë votën. Dhe ky është qëllimi. Nuk e kemi qëllimin unë jam më i zëshëm dhe unë më i kthjellët në këtë temë dhe unë di të them më mirë dhe di të akuzoj më shumë. Në

momentin ku jemi ne duhet të veprojmë shumë konkretisht sepse jemi në procedurë ku po rrjedhin afatet. Konsideroj se duhet të ecim para dhe duhet ta kemi listën e gatshme.

Premtim Rrustemi: Sa i përket 11,604 i kemi cekur arsyet e refuzimit. Ku nuk janë plotësuar kriteret dhe në bazë të kriterëve ata janë refuzuar. Ndërsa këta 146 aplikues të cilët janë refuzuar sepse nuk kanë pasur numrin e telefonit ne jemi bazuar në aktvendimin e KQZ-s që e kemi marr se të gjithë aplikuesit do të telefonohen, prandaj ata që nuk kanë pasur numër të telefonit nuk kemi mundur ti verifikojmë a janë ata persona apo jo dhe për këtë arsye është ajo kategori e tyre. Ndërsa 470 aplikues që kanë dërguar për anëtar të ngushtë të familjes i kemi verifikuar se nuk kanë qenë 2 deri në 3 mbiemra por ka pasur mbiemra të ndryshëm për këtë arsye është kjo kategori, i kemi verifikuar mbi 6 mbiemra të ndryshëm që kanë ardhur në një e-mail. Prandaj është ky numër 470 nuk është familje e ngushtë një deri në dy mbiemra, kjo është arsyeja.

Sami Kurteshi: Sa raste ka pasur kur janë dërguar shumë aplikime vetëm me një numër të telefonit me mbiemra ta ndryshëm? Dhe sa raste kemi pasur kur prej një e-maili me mbiemra ta ndryshëm me adresa të ndryshme.

Premtim Rrustemi: Nuk ka pasur shumë prej një e-maili ka pasur aplikime të shumta vetëm se prej një mbiemri ka pasur mbiemra ta ndryshëm. Ka pasur 19 aplikacione me mbiemra të ndryshëm prandaj është kategoria me 146. Nga numri nuk kemi mundur të nxjerrim kategori sepse ka pasur numra që nuk kanë pasur hyrje, kanë shënuar vetë +00 dhe nuk ka ndonjë statistikë të saktë se sa persona kanë aplikuar prej një numri të telefonit. Është përdorur format i njëjte me atë të numrit kur e kanë shtypur ose kanë shënuar pa hyrje prandaj për këtë arsye nuk mundemi të bëjmë statistikën se sa persona kanë aplikuar prej një numri të telefonit. Mundemi më vonë ta bëjmë por për momentin nuk mundemi.

Burim Ahmetaj: Kisha me qenë mirë ta votojmë rekomandimin mirëpo sekretariati çka ka bërë e ka zbatuar vetëm vendimin e KQZ-s nuk e kemi shkelur vendimin që e kemi pasur para vetës.

Valdete Daka: Kush është për certifikimin e listës përfundimtare? Faleminderit, janë dhjetë (10) vota për...

Sami Kurteshi: U miratua lista e gjithë aplikuesve ku sipas kriterëve që i diskutuam janë të suksesshëm. S'i do të mbetet çështja e sfidimit ose shfrytëzimit të drejtave juridike të atyre që janë refuzuar.

Burim Ahmetaj: Posa ta marrim miratimin e KQZ-s ne do ti publikojmë emrat e të gjithë aplikuesve të suksesshëm dhe të gjithë ata që nuk e gjejnë vetën në listën e aplikuesve të suksesshëm atëherë mund ta sfidojnë në PZAP.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër miratimi dhe shqyrtimi i fletëvotimit. Që të mund të publikohet menjëherë...

6.Shqyrtimi dhe miratimi i fletëvotimit dhe broshurës për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021:

Burim Ahmetaj: Kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar në KOZ dhe praktikisht nuk ka mundur të kaloj as fletëvotimi dhe as broshurat për të cilat është propozuar dhe KOZ-i e ka trajtuar së bashku. Përderisa nuk e kanë marr miratimin asnjëra është sjell direkt në KOZ. Fletëvotimi i përmban të gjitha kriteret e përcaktuara me fletëvotime pra përmban logon e KOZ-s, emrin e subjektit, numrin e subjektit sipas shortit që është hedhur po ashtu edhe emrin e subjektit politike. Po ashtu në anën e djathtë është edhe numri i kandidatëve për rubrikat ku do të shënohen kandidatët nga një deri në 110 për secilin subjekt politik. Mirëpo kemi edhe subjekte të tjera të cilat kanë vetëm pesë kandidat dhe ata pesë kandidat janë të certifikuar. I ka elementet që nuk ka ndryshuar nga zgjedhjet e kaluar dhe rekomandimi është të miratohet si i tillë.

Valdete Daka: Pra, i kemi dy lloje të fletëvotimeve. Është edhe fletëvotimi ku paralajmërohet edhe gjuha e komuniteteve dhe ku aplikohet pra. E kemi fletëvotimin e par i cili është në gjuhën shqipe dhe serbe. Dhe e kemi fletëvotimin i cili është në gjuhën serbe dhe turke. Pra unë e qes së pari në votim fletëvotimin e parë. Kush është për?

Arianit Elshani: Sa i përket fletëvotimeve në parim jam për, përveç pjesës ku e ka bërë PDK në afatin kohor të rregullt ku ka aplikuar në afatin e rregullt ka pasur një kërkesë duke respektuar edhe ligjin edhe rregulloret lidhur me përfshirjen e sloganit “Rimëkëmbja” siç ka ndodhur edhe në zgjedhjet e kaluara të 6 tetorit 2019 ku subjekte politike kanë pasur slogane e tyre brenda fletëvotimit. Kërkoj që të propozohet. Kërkesa ka qenë subjekti politik PDK-ja nuk është informuar në këtë rast nga KOZ-ja përse nuk është përfshirë si slogan në afatet kohore të caktuar me ligj brenda afatit kohor për pesë ditë. Unë po i referohem edhe një rregullore të KOZ-s, ku neni 3 i rregullores për certifikimin e subjekteve politike të kandidatëve të tyre neni 3. Aplikimi për certifikim të një subjekti politik pika 3.2A emri dhe akronimi siç dëshiron subjekti politik duhet të figuroj në fletëvotim. Është kërkesë që edhe dje tek këshilli e kemi parë të gjithë si anëtar të KOZ, fatkeqësisht ajo mbledhje nuk përfundoj dhe nuk hyri fare në votim as fletëvotimi as broshurat. Dhe kërkoj që kjo të përfshihet duke i përfillur rregulloren që daton nga viti 2013 por ku është

aplikuar edhe në zgjedhjet e fundit, ku ka qenë edhe si kërkesë e PDK-s por ka qenë pas kalimit të afateve kohore. Kërkoj që komfort rregullave dhe ligjeve të përfshihet edhe ajo kërkesë e subjektit politik PDK-s.

Eshref Vishi: Megjithatë ne e kemi dhënë një rregullore 02/2020 të fletëvotimit dhe broshurave dhe mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet në përputhje me nenin 03, mbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit dhe broshurës. Unë nuk shoh që të figuron edhe slogani i subjektit politik ku megjithatë ka kushte që duhet ti përmbahemi një fletëvotimit.

Arianit Elshani: Nuk po kërkoj asnjë favor, po kërkoj atë që është e rregulluar edhe me ligj edhe me rregull. Para se të shkoj tek rregulla e fletëvotimit që është fazë përfundimtare i cili është afati për certifikim të subjekteve politike. Pra edhe nëse ai subjekt politik është i certifikuar për shkak se ka një deputet në parlament atëherë ai prapë duhet ta dërgoj kërkesat dhe dokumentacionin e tij ta bashkëngjis dhe ti dorëzoj në ZRPPC. Në këtë rast PDK-ja e ka bërë brenda afateve kohore, po i referohem rregullës së fletëvotimeve sepse më pas vjen ajo rregull e fletëvotimeve ku përfshihet emri dhe akronimi i një subjekti politik ashtu siç dëshiron të figuroj në fletëvotim.

Sami Kurteshi: Thuhet emri dhe akronimi siç dëshiron çdo parti politike. Nuk është slogani por është akronimi. Kjo është sipas asaj rregullore që po e lexoni ju dhe nuk është slogani por akronimi. Akronimi është shkurtesa që e mban një parti politike. Nëse e kam kuptuar drejt sepse ishte fjala për slogan.

Valdete Daka: Është e vërtet përmbajtja e fletëvotimit. Thotë se fletëvotimi përmban në shkronjën F akronimin e secilit subjekt sipas shortit dhe radhitjes në fletëvotim.

Arianit Elshani: Është rregulla për certifikimin e subjekteve politike, ku thotë emri dhe akronimi i subjektit politik ashtu siç dëshiron të figuroj në fletëvotim. Unë po ua referoj bazën ligjore dhe po ju njoftoj që PDK-ja nuk është njoftuar brenda afateve pavarësisht kërkesës që e ka bërë brenda afatit kohor. PDK-ja nuk është njoftuar nëse kjo do të figuroj edhe pse ka qenë kërkesë edhe në CD edhe në aplikacion në dosje, nuk është njoftuar PDK-ja çoftë se kjo kërkesë do të përfshihet apo nuk do të përfshihet në fletëvotim. Unë ju referova edhe rregullores edhe ligjit ku thotë që subjektet politike duhet të njoftohen.

Eshref Vishi: Unë mendoj që sa i përket përmbajtjes së fletëvotimit tek paragrafi P emrin dhe akronimin e subjekteve politike vijnë sipas radhës së shortit për fletëvotimin duhet të jetë i njëjtë për të gjitha subjektet politike jo vetëm për një subjekt politik.

Sami Kurteshi: Unë kam një pyetje për drejtorin e ZRPP-s ta konfirmoj ose ta kundërshtoj një çështje që unë po dua ta cek. Para disa muajsh ka qenë çështja e ndryshimit të akronimit të partisë Social Demokrate.

A bënë të na sqarohet rasti për çka është fjala. Unë e di që edhe logo mund të ndryshohet, edhe akronimi mundet të ndryshohet por për atë janë të parapara vendimet e organeve të caktuara të partisë politike, kuvendit apo këshilli i përgjithshëm.

Ylli Buleshkaj: Ne i kemi shumë të qarta siç e ceku Z. Vishi se çka duhet të duket në fletëvotim e cila ne nuk mund të bëjmë asgjë më shumë emrin, akronimin. Subjektet politike aplikojnë me një emër ashtu siç janë të regjistruara. Siç e ceku edhe Z. Elshani, subjekti në fjalë nuk ka pasur nevojë as të certifikohet si subjekt politik pasi që i ka plotësuar kushtet automatikisht të certifikohet. Puna pse nuk është përfshirë ajo e kemi sepse është rregull e re por shumë e qartë dhe nuk mundemi të rekomandojmë diçka çka nuk është në rregull ta aprovojmë nga KQZ-ja vitin e kaluar. Ajo që është kemi shkuar hap pas hapi siç ka kërkuar rregulla.

Arianit Elshani: Unë ju referova edhe në ta kaluarën. Drejtori ka qenë edhe në të kaluarën në zgjedhjet e 6 tetorit. Ka pasur subjekte politike të cilat e kanë pasur edhe sloganin brenda saj. Ka qenë kërkesë edhe e PDK-s herë e kaluar jashtë afatit kohor, ju referova ligjit PDK-ja nuk është njoftuar kërkesën e keni pasur në dosje. Subjekti nuk është njoftuar a përfshihet apo nuk përfshihet dhe arsyet pse, kjo ka ardhur si vendimmarrje e as nuk është propozuar brenda fletëvotimit. Unë këtë po e them pse nuk është njoftuar dhe tjetra bazë ligjore ka, në këtë rast e ke edhe në rregullën për certifikim dhe aplikim ku i lejohet që të zgjedh emërtimin e saj brenda fletëvotimit. Ju e thatë që ligji certifikon automatikisht, mirëpo është edhe çështja tjetër që pavarësisht asaj subjektet politike duhet ti dërgojnë të gjithë ato dokumentacione duke përfshirë shtojcën një dhe nëse e shihni në shtojcën një nuk ka vend për slogane deri sa karaktere ka në formular për certifikim. Formular të cilin e ka dorëzuar PDK-ja edhe fletën por edhe dizajnin. Andaj kërkoj mbështetje nuk e shoh si favor e shoh si çështje e cila është brenda ligjit dhe brenda rregullës. Unë prapë i nënshtrohem demokracisë, procesit të votimit dhe kërkoj mbështetjen për këtë çështje.

Eshref Vishi: Nuk e kam qëllimin të replikoj ose të mohoj për një pretendim të kolegut. Mirëpo megjithatë rregulla për përmbajtjen e fletëvotimit dhe broshurave është specifike në krahasim me rregulle të cilin po e përmend Z. Elshani. Kjo ka të bëjë me përmbajtjen e përshkrimit të fletëvotimit dhe broshurave, në mënyrë specifike është paragrafi R.

Arianit Elshani: Brenda afatit nuk është njoftuar. Tjetra e keni pasur edhe kërkesën dhe verbalisht keni biseduar me përfaqësuesin juridik të PDK-s. Nuk i është sqaruar kjo çështje. Dhe i keni pranuar dhe në heart copy ka qenë edhe kërkesë në CD. Nuk keni formular të posaçme për këtë çështje është e drejt

kërkesa që ka bërë PDK-ja, të cilën nuk është përgjigjur. Unë po e kërkoj po e shoh brenda ligjit, brenda rregullës. Kjo rregull e fletëvotimeve vjen pas rregullës së certifikimit të partive politike.

Ylli Buleshkaj: Po e shoh si rregull shumë e qartë që e ka bërë kjo KQZ me anëtarët e tanishëm. Po e përmendi një rast në të kaluarën partitë politike kanë mundur ta kenë sloganin, por slogan nuk ka qenë emrin e ka pasur koalicioni. Koalicionet e reja e zgjedhin një emër edhe ta zëmë ka qenë koalicioni i dy subjekteve politike e cila ka pasur një emër “Për Kosovën”, ai ka qenë një koalicion si subjekt i ri politik nuk ka qenë slogan i një të kaluarë. Përveç asaj tani e kemi një rregull e cila e specifikon diçka që ka mundur të jetë edhe herëve të kaluara më e ndjeshëm e rregulluar dhe jemi shumë strikt në këtë rast. Nuk mundemi të rregullojmë diçka tjetër. Kjo mundet të aprovet por rregulla e KQZ-s e ka rregulluar këtë sferë.

Valdete Daka: A kemi diçka tjetër? Nuk na mbetet gjë tjetër vetëm ta qesim në votim kështu siç është... Kush është për këtë fletëvotim siç është? Kush është kundër? Kush abstenon? E kemi fletëvotimin me tri gjuhë. Kush është për këtë fletëvotim me tri gjuhë? Kush është kundër? Kush abstenon? Kush është për rekomandimin e Arianitit? Kush është kundër? Kush abstenon? E lus sekretariatit që ta publikoj në ueb-faqe menjëherë këto dy fletëvotime, së bashku me listën përfundimtare që të filloj votimi...

Burim Ahmetaj: Duke ju referuar fletëvotimit një informacion për votuesit të cilët votojnë jashtë vendit se fletëvotimin mund ta printojnë nga shtëpitë e tyre me formatin A3 apo A4 nuk ka lidhje a do të jetë me ngjyra apo nuk do të jetë. Kështu që fletëvotimi mund të printohet nga printeri i thjeshtë. Ndërsa fletëvotimi i cili përdoret në zgjedhjet brenda territorit të Republikës së Kosovës i ka të gjitha elementet e sigurisë dhe është origjinal që po ashtu e ka edhe numrin e vendvotimit sepse janë të personalizuar. Dhe nuk mund të përdoret asnjë fletëvotim tjetër përpos fletëvotimin që e ka miratuar KQZ-ja. Pra për votuesit nga diaspora mundet të printohet me një printer të thjeshtë me fletë të thjeshtë A3 apo A4. Ndërsa sa i përket broshurës së kandidatëve edhe kjo pikë është trajtuar dje në KOZ e cila nuk ka mundur të arrij të kalojë në KOZ. Unë po e bëj një prezantim të shkurtër të asaj çka përmban broshura. Faktikisht nga rregulla për fletëvotime dhe për broshura ajo obligon DOZ-in, neni 3.2 dhe pika F e obligon sekretariatit ta bëjë dizajnin e fletëvotimeve dhe të broshurës në bazë të informacioneve të cilat vijnë nga ZRPP-ja. Mirëpo kemi pasur një konfuzion të vazhdueshëm i cili nuk ka qenë i sqaruar qartë nga zyra se çka duhet të përmbaj broshura. Dhe për kundër tentimeve, komunikimeve nuk kemi pasur asnjëherë ndonjë konfirmim dhe sidomos tek numrat të cilët nuk ka emra të kandidatëve të certifikuar. Pas shumë komunikimeve prapë se prapë nuk kemi marr një sqarim të qartë nga zyra se si duhet të veprohet në rastet kur kemi numër por nuk kemi kandidat të certifikuar si të tillë e kemi sjell prapë në KQZ dhe tash

është çështje e KQZ-s në lidhje me broshurën dhe çka duhet të përmbaj broshura me të gjithë emrat e kandidatëve.

Valdete Daka: I kemi broshurat me dy gjuhë dhe me tri gjuhë. I kemi broshurat e të gjitha partive politike të certifikuara me emrat e kandidatëve të certifikuar por kemi edhe siç e tha Burimi disa subjekte numrat të cilat nuk kanë emra. A ka dikush pyetje.

Eshref Vishi: Unë e di se çdo proces zgjedhor ka sfidat dhe veçoritë e veta. Por sfida është paraparë heqja e kandidatëve nga lista e subjekteve politike në bazë të përshtatmërisë të nenit 29 të ligjit për zgjedhje e përgjithshme proces i cili është zhvilluar nga ZRPP-ja, i vendosur nga KQZ-ja dhe më pas i apeluar në PZAP dhe Gjykata Supreme për subjekte politike. Vendimet dhe aktgjykimet e këtyre instancave duhet të zbatohen nga KQZ-ja dhe për këtë besoj që ka dilema nga askush nga kolegët këtu. Është përgjegjësi e jona për administrimin e aspekteve teknike të procesit të votimit në mënyrë që mos të provohen efekte teknike të gabimit eventual në evidentimin e rezultatit të votës për kandidat. Formulari i përputhjes së rezultateve dhe broshura mendoj se duhet të dizajnohen në harmoni me gjendjen nga certifikimi i listave të kandidatëve të subjekteve politike. Në këtë aspekt do ishte mirë që mos të lihet dilemë tek KVV-t se si duhet të veprohet në plotësimin e formularit për përputhjen e rezultateve. Andaj nuk duhet të paraqiten kolonat me emra të zbrazëta e as të hijezuara por mendoj se duhet të largohen në tërësi. Subjekte politike nuk i kanë riradhitur sipas kërkesës së KQZ-s si dhe kandidatët e certifikuar e ruajnë numrin e përcaktuar me rastin e aplikimit për certifikim. Mendoj se kjo është forma më e mirë që të ruhet mbarëvajtja e procesit të numërimit dhe kështu hiqen dilemat dhe lehtësohen veprimet në KVV në ditën e zgjedhjeve përkatësisht në procesin e numërimit të votave për kandidat. E them për arsye se broshura duhet ti paraprij edhe FPR-s, nga broshura varet edhe dizajni i formularëve. Unë po e shoh që ka propozim tek numrat të cilat nuk janë certifikuar kanë mbetur zbrazët numri dhe më pas emri dhe mbiemri nuk figuron fare prandaj mos të krijojmë huti tek anëtarët e KVV-e.

Alim Rama: Mbrëmë në mbledhjen e KOZ-it as broshura as fletëvotimi nuk kanë marr vota të mjaftueshme. Por sa i përket argumentit të Z. Vishi, unë e mendoj të kundërtën dhe mendoj se ajo duhet të vijë si lidhje me secilin subjekt. Në fund të fundit vota për subjekt janë ato vota që e përcaktojnë validitetin e një fletëvotimi. Gjasa për të gabuar në vendvotim nga KVV-t është shumë më e madhe çoftë se këto hapësira që janë midis listës së kandidatëve mungojnë. Sepse duke e marr parasysh procesin sic është, njëherë mbushen listat siç është pikat ku janë vetëm numrat dhe subjekti. Numri fillon prej 100 nga secili klik dhe përfundon tek 110, bartja duhet të jetë një për një zakonisht në punë serike shkon. Njëshi ka marr kaq vota transmetohet në FRK tek formulari i kandidatëve konsultimit për kandidat dhe ka numrat

e kandidatëve. Njëshi tek njëshi, dyshi tek dyshi e kështu me radhë. Në këtë mënyrë në QNR bëhet bartja po ashtu njëjtë sepse ajo i shmang nga mundësia që të bëhet bartja prej një numër në numër tjetër për shkak të automatizimit këto punë kryhet teknike sepse një person lexon tjetri shkruan. Ndërsa kur i bie tek paraqitja e raporteve të KQZ-s atëherë në raport figurojnë vetëm kandidat të cilët janë certifikuar ajo është procedura siç shkon, kështu që njëherë si kryesues i këshillit të KOZ-it rekomandoj që të kaloj si i tillë por nëse ndonjë subjekt kërkon ti lëviz zbrazëtitat le ti bëjë për vete. Mendoj se këto vota edhe janë të subjektit, i takojnë subjektit radhitja e kandidatëve i takon brenda subjektit. Kështu që qëndrimi jonë edhe si LVV për këtë rast rekomandojmë që të mbetet ashtu siç është rekomanduar dhe kjo është edhe me vendimin e PZAP-it, ku ndalohet zëvendësimi. Kështu që unë jam të votohet kështu siç është por nëse ndonjë subjekt dëshiron të bëjë ndryshime është e drejt e tyre.

Eshref Vishi: Ky vendim duhet të jetë unik nuk guxon të bëjmë laramani tek disa subjekte. Megjithatë jemi në prag të miratimit të KVV-e dhe ato kontakte të KVV-e do të ketë edhe trajnime. Besoj se trajnerët do ti sqarojnë këto probleme teknike në ditën e votimit përkatësisht ditën e numërimit të votave.

Ibrahim Selamanaj: Po flas në aspektin teknik dhe po i referohem përbërjes që është në kuvend në kuadër të organizimit të zgjedhjeve. Këto nuk janë zgjedhjet e para janë vetëm vazhdimësi. Vetëm një dilemë po flas në aspektin teknik kemi numër 19 dhe 20 është i zbrazët dhe kandidati ynë nuk është i certifikuar. Në diskutim kur e bëjmë kandidati ynë i pa certifikuar, është vendim i Gjykatës Supreme vendim të cilin duhet ta përfillim sepse gjykata ka sjell një realitet të ri. Ky numër është i tepërt. Dhe tash e kemi edhe situatën tjetër kemi numrin 70. Ne nuk i shohim komisionerët atje në Kaqanik, Istog, dy skajet. A mund të shfaqet një dilemë edhe ata të mos e nënshkruajnë fletëvotimin sepse një votues potencial i numrit 20 e shenjzën 20 dhe pesë të tjerë. Dhe nuk po dua të hap dilema por thjeshtë sugjerim në aspektin teknik të organizimit mirë kishte me qenë të hiqen këta numra.

Alim Rama: Vetëm desha t'ju përkujtoj se fletëvotimi është 1 deri 110, rregulla është e qartë, ligji është i qartë. Nëse dëshironi i referohemi edhe ligjit, neni 180 të ligjit të përplotësuar. Votohet për një subjekt politik dhe përfaqëson votën e subjektit. Votohet deri në pesë kandidat dhe në rast nëse votohen më shumë se pesë vota për asnjë kandidat nuk llogaritet për subjektin politik, ajo është ligji. Tash sa i beje ajo tek bartja sa i përket rendimit të komisionerëve, trajnimi i trajnerëve është kryer dhe nuk është mirë të ndërrohet procedura e procesit nuk ka nevojë sqarime. Shumica e këtyre komisionerëve ka marr pjesë në zgjedhjet e kaluara, e dinë procedurën kështu që bartja një për një është bartja më e saktë dhe eviton problemet. Ne vetëm se e kemi pasur një problem në zgjedhjet e kaluara ku ka munguar një kolonë dhe ka krijuar telashe, tash çdo mungesë e kolonës krijon përsëri telashe sepse ne e kemi par se aty bëhet

bartja në mënyrë mekanike një, dy, tre, lexomi i shkruaj, pavarësisht çka figuron aty. Unë kur e thash procedurat janë si janë klikat siç ju referua sekretariati atyre formularëve apo fletave të kandidatëve të punës ato nuk kanë as emër janë vetëm numra rendor nga 1 deri në 110. Dhe zakonisht fillon një X vota, dy Y numri i votave dhe ajo është procedurë mekanike dhe duhet të mbetet procedurë mekanike. Nuk duhet askush të ketë të drejt të interpretoj ku është dhe e cilit është ajo vota, interpretimin e ka dhënë gjykata dhe ajo zbatohet në raportet e KQZ-s.

Eshref Vishi: Unë po mendoj se ne duhet të debatojmë dhe ta shqyrtojmë mundësinë e pranueshme që në ditën e votimit të mos kemi probleme teknike sa i përket bartje së të dhënave apo numrit të votave për kandidat. Për aq sa e paraqet si pengesë Z. Alimi, mos ekzistimin e një kolone unë e shoh si problem ekzistimin e saj për arsye se mund të gabohet eventualisht kemi një zbrazëtirë pa emër e pa mbiemër ndoshta edhe pa numër fare atëherë mundësia e gabimeve është evidente. Mirëpo unë dua të lidhem dhe tek rregulla që e përmendëm pak më herët lidhur me përmbajtjen e fletëvotimit dhe broshurave në nenin 4.2. Ajo thotë kështu, menjëherë pas certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje departamenti i teknologjisë informative bënë dizajnin i fletëvotimeve dhe broshura bazuar në informacionet e pranuar nga ZRPC-ja. Tash ZRPC-ja ka pranuar aktvendimet dhe aktgjykimet e ZRPP-s dhe Gjykatës Supreme. Mbi bazën e këtyre janë hequr kandidatët atëherë unë nuk shoh ndonjë arsye pse duhet të ekzistoj numri, pse duhet të ekzistoj zbrazëtira. Vetëm krijon huti dhe duhet ti përmbahemi aktvendimeve dhe aktgjytimeve të gjykatës.

Sami Kurteshi: Unë e dëgjova kolegun Vishi i cili e lexoj dhe nuk po e kuptoj çka është lidhja e asaj me këto, këtu. Cilit do subjekt politik këtu i intereson të bëjë ri radhitjen e listave të veta e ka të lirë ta bëjë dhe asnjë subjekt nuk e pengon këtu ta bëjë ri radhitjen e listave. Lista e LVV-s ka shkuar kështu me 110 kandidat ka respektuar vendimet, se ne mendojmë se janë ta pa drejta të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme. Ata kanë thënë se nuk kanë të drejt të zëvendësohen, ne nuk i kemi zëvendësuar dhe kemi lënë listën ashtu sic është. Nëse ju mendoni me lojë fjalës në këtë formë ta rregulloni listën e LVV-s kjo nuk bënë. Ju e keni të lirë ta ndryshoni listën e juaj, me e ri radhitë, me vepruar si të doni dhe unë e respektoj vendimin për subjektin e juaj. Por nëse e mendoni ri radhitjen e subjektit politik VV-je ajo nuk do të bëhet. I ka respektuar të gjitha normat ligjore, gjitha vendimet dhe unë mendoj se këto duhet të shkojnë kështu edhe në aspektin teknik nuk paraqesin problem, as në aspektin politik nuk paraqesin problem dhe as në aspektin juridik nuk paraqesin problem. Nëse shkohet me këto fjalë që mund të gabohet, ne të gjithë mund të gabojmë. Unë mendoj se ky është një veprim, përpjekje për të bërë diçka, a keni problem me listën tuaj. Nëse keni ju lutëm kërkoni ta ri riradhisin dhe unë e pranoj atë ndryshim që e bëni ju. LVV-je

nuk e ka ndërmend ta ndryshoj listën përveç se siç është kështu. Kjo është çështja që ne nuk po dëshirojmë ta diskutojmë dhe mendoj se këtu duhet të pranohen kështu, çdo subjekt politik ka të drejt ta ri radhis listën e vet.

Eshref Vishi: Unë nuk po e bëjë avokatin e asnjë subjekti politik këtu, po e jap kontributin tim lidhur me zgjedhjen e këtij aspekti teknik që mendoj se duhet të jetë dhe do të jetë i kushtueshëm për kandidatët e subjekteve politike tek numërimi i votave. Ri radhitjen secili subjekt e bënë për vete. Unë nuk po flas për partin e juaj politike po flas për partin time politike që ka vendosur se nuk ka ri radhitje, mirëpo si rrjedhojë dhe pasoj e ri radhitjes ne kemi zbrazëtira tani në broshurë dhe do ti kemi edhe në formularin e përputhjes së rezultateve i cili nuk bëhet vetëm për VV-n ose për Nismën në këtë rast si subjekt politik por bëhet për të gjitha subjekt politik garuese. Në mënyrë që mos të vjen deri tek problemet. Mendimi im dhe sugjerimi im është që të hiqen këto zbrazëtira. Tash është e drejt e KQZ-s që të votohet njërin opsion ose tjetrin.

Alim Rama: Një keqkuptim nga Z. Vishi. Gjithmonë e përmend përputhjen e rezultateve. Formulari i përputhjeve të rezultateve nuk i ka emrat e kandidatëve aty, ai është formular tjetër siç ju referua sekretariati është FRK-ja. Në formular të përputhjes së rezultateve janë vetëm emrat edhe votat e subjekteve politike, ato nuk afektohen nga listat e kandidatëve. Nuk janë të njëjta, janë dy dokumente të ndara. Unë siç e thash, rrezikshmëria çoftë se largohen zbrazëtirat por edhe në formular të kandidatëve secila parti. Edhe sekretariati mundet të na jap një formular të kaluarës aty radhitet secili subjekt, që fillon LVV-ja dhe fillon kolona për secilin kandidat të LVV-s. Ky është qëndrimi, kjo është lista jonë. Pastaj fillon me partitë e tjera. Kur vije puna deri këtu Z. Vishi mundet ti largoj nga lista e Nismës, sepse ato janë FRK-t ndaras me parti nuk kanë të bëjnë me të gjithë.

Sami Kurteshi: Nëse nuk pranohet propozimi i sekretariatit. Çfarëdo loje e karakterit politik, Z. Vishi edhe juve po ju drejtohem edhe çdo kujt tjetër. Secili na ju keni të drejt ti ndryshoni listat e partive të juaja sipas dëshirës së juaj. Lista e LVV-s nuk ndryshon nga kjo që është këtu. Këtë duhet ta keni parasysh. Dhe unë e quaj sabotim të zgjedhjeve kjo tryezë vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës. Vullnetin politik të qytetarëve të Republikës së Kosovës ka për ta vendosur kutia e votimit me 14 shkurt. Ju mund ta ndryshoni subjekti i juaj, LVV-je e ka dërguar një listë prej 110 kandidatëve me ata emra, në formën si është dhe në atë formë ka për të mbetur. Çdo votim tjetër çdo ndryshim i kësaj për ne është i papranueshëm.

Eshref Vishi: Një shpjegim ligjor dhe procedural dua ta jap. Çdo kush që nuk është i kënaqur me vendimet e KQZ-s dhe tenton se ju është shkelur e drejta e subjektit politik atëherë ka të drejt apelimi në PZAP.

Alim Rama: Unë nuk e di kush e merr të drejtën këtu. E dëgjova pak Z. Hamiti ose Z. Vishi të na përcaktoj neve LVV-s siç do të duket pjesa e formularit ku ceket LVV-je. Dhe unë sa e lexova çka qëndron në ueb-faqen e KQZ-s. Për çka qëndrojmë në? KQZ është përgjegjës për organizim dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovë. Roli i KQZ është të rregulloj procesin elektoral përmes miratimit të rregullave zgjedhore dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në të gjitha aspektet për të siguruar që zgjedhjet arrijnë standardin ndërkombëtar. Unë si dikush që ka punuar sipas standardeve ndërkombëtare, si një person që kam udhëhequr shumë misione të Kombeve të Bashkuara që i kanë caktuar këto standarde ndërkombëtare me përvojë të plotë dhe përgjegjësi po e caktoj. Ka pasur rast që dy dit para zgjedhjeve janë fshirë kandidatët prej listës ose për shkak të aksidenteve ose për çfarëdo arsye tjera. Komisionerët trajnohen në procedura standarde. Këto janë standarde jo të rregullta të cilat secili që tenton ti laroj shkon një për një përshkrimi. Se në momentin që shkon propozim tjetër unë pajtohem Z. Vishi ose dikujt tjetër që dëshiron ta ndërroj listën e vet. Unë e shpjegova më herët qysh është procesi teknik por më duket se po hasin në vesh të shurdhër këtu. Procesi teknik është që formularët nuk kanë as emër as mbiemër, formularët e parë që pas së cilave numërohet çdo votë janë njësoj. LVV-je shkruan mbi dhe fillon nga 1 deri në 110 pa asnjë emër. Bartja kur e lexon një komisioner, thotë njësi 500 vota, dyshi 300 vota, treshi 300 vota sa do që të jenë me radhë. Ajo bartja shkon një dy tre nuk lexohen emrat dhe kjo bartja pastaj kur shkon në sistem fillon me rend, një, dy, tre, katër, vetëm i qet sa është njëshi, sa dyshim sa treshi. Përpjekja për ti larguar këto kolona është përpjekje e qëllimshme që të krijoj problem në listën e LVV-s nuk ka të bëjë me asnjë subjekt tjetër. Unë i shpjegova edhe privatësisht Z. Vishi më poshtë por është e drejta e tij. Unë e them secili i ka FRK-t formularin e përputhjes së rezultateve të kandidatëve i ka të qarta kolonën për secilin subjekt politik. Në momentin që FRK-ja, ne çoftë se LDK-ja dëshiron ti bëjë numrat 1,5,9,3 qysh dëshiron le ti bëjë është çështja e saj. Lista e subjekteve tjera është çështje e subjekteve të tjera. Kështu që lista jon është ajo, vetëm desha të ju përkujtoj edhe diçka tjetër. A mundet dikush me më treguar në cilën rregullore thotë, në momentin e kalimit të sekretariatit nuk kalon mundet mbledhja të vazhdoj. Sepse na një herë e kemi thyer këtë ligj në mënyrë procedurale.

Arianit Elshani: Ka qenë një kërkesë zyrtare në dokumentacion, në dosje kërkesa e PDK-së. Ju referuat kësaj rregullore që po ju referohet Z. Vishi në këtë rast. Në bazë të asaj rregullore e hodhët poshtë kërkesën e PDK-s, e hodhët edhe në votim. Kërkoj që të vazhdoni, të procedoni me proces të votimit.

Alim Rama: Rekomandimet e sekretariatit vijnë për edhe kundër. Në momentin që janë kundër nuk kalon rekomandimi i sekretariatit edhe përmbillet procesi.

Valdete Daka: Ju deri tash folët që na jemi duke prit diasporën të votoj. Diaspora nuk mundet të filloj të votoj pa i aprovuar edhe broshurat sepse këto broshura ata duhet me i pas, me ditë se cili numër, edhe cili numër me u orientuar. Ne e kemi një propozim të sekretariatit për këto broshurat të cilat pas disa çasteve priten të publikohen në ueb-faqen ton dhe pritet të fillon votimi i diasporës, aq shumë i pritur. Kështu që ne duhet me e proceduar, me votu ose mos me votu. Si do që ta shihni ju, na duhet me e qit në votim edhe unë nuk kam tjetër mundësi pos ta qes në votim broshurën ashtu siç është dhe ta përfundojmë këtë procedurë.

Sami Kurteshi: U përmend këtu pengesa për mërgatën. Na e dimë kush ka qit pengesa për mërgatën. Ne këtu ende nuk kemi marr guximin me fol me emra. Është në pyetje emri Albin Kurtit jo veç që e përjashtojnë atje por nuk dëshirojnë ta kenë as numër kjo është çështja Z. Vishi ose kushdo tjetër kot e keni. 14 shkurti ka me ardhur edhe ka me tregu. Kjo çështja me listën e LVV-je Z. Vishi ka përfunduar. Ju po e ngritni me qëllim dhe ne e dimë cili është qëllimi. Dhe ai qëllim nuk ka për tu arritur, 14 shkurti ka për ta treguar kush ka pasur çfarë qëllime dhe pse i ka pasur. Unë po them kjo listë e LVV-s ka për të shkuar kështu e nëse ju bëni me e ndryshuar këtë listë. Unë po them ne nuk e pranojmë këtë vendim. Është sekretariati ka propozuar, nuk ka asnjë normë ligjore që e keni në ligjet në fuqi, asnjë rregull asnjë vendim administrativ që e kërkon këtë por e ngritët në mënyrë artificiale vazhdoni në mënyrë artificiale. Listën e LVV-s nuk e ndryshoni.

Alim Rama: Ju keni referuar rregullores për broshura por kjo nuk përmban asgjë emrin, mbiemrin, subjektin politik. Punë është që ne nuk e kemi paraparë këtë me ligj kështu që as që e kemi ditur. Ne 11 veta nuk kemi të drejt të ndërhyjmë në proces, lista e kandidatëve është individuale për secilën parti. Duhet të jemi të sigurtë mbrëmë të 4 keni votuar kundër broshurës së sekretariatit.

Valdete Daka: Momentin që i keni para vetës këto dy broshura unë i qes në votim. Kush është për këto broshura ashtu siç janë? Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon? Kush është për propozimin që e dha Eshref Vishi? Kush është që të hiqen numrat rendor dhe zbrazëtirat? Faleminderit. Tetë vota për, faleminderit...